

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
II.	HYRJA	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7
8.	Dokumentimi i auditimit	7
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	8
2.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	8-10
1	Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.	
2.2	Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit	10-14
1	Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.	
2.3	Të tjera	14
IV.	REKOMANDIME	15-18

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1462/1, datë 06.01.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditori Qendrën e Arsimit Lushnje, për periudhën 01.01.2023 deri më datën 31.12.2024.

Grupi i auditimit pasi mbledhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në Qendrën e Arsimit Lushnje, është pjesë e Planit Vjetor 2025 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, në Qendrën e Arsimit Lushnje, si dhe në rastet kur institucioni ka qenë përfitues shërbimi nga Bashkia Lushnje.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditorësh filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.1462/1 me datë 06.01.2025.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Qendra e Arsimit Lushnje nuk disponon një strategji dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre;
- Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka hartuar regjistër risku lidhur me teknologjinë e informacionit dhe se nuk janë dokumentuar rreziqet e identifikuara për periudhën objekt auditimi, si rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e teknologjinë së informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje;
- Me Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura dhe organika e Qendrës Arsimore të Bashkisë Lushnje për vitet 2023 dhe vitin 2024, ku në asnjërin vit nuk është parashikuar ngritja e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe as përfshirja e një pozicioni specialisti për këtë fushë. Kjo situatë pengon implementimin e rregullave të komunikimit dhe shkëmbimit elektronik të dokumenteve zyrtare. Mungesa e këtij sektori dhe e stafit të specializuar ka penguar dhe vijon të pengojë implementimin e duhur të rregullave për komunikimin dhe shkëmbimin elektronik të dokumenteve zyrtare, duke mos respektuar rregulloret e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe kërkesat e nenit 37 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë Lushnje.
- Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje për vitin 2023, nuk ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionim e saj. Ndërsa, në vitin 2024 është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lushnje, rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Arsimore. Specifikisht, në rregulloren e vitit 2024 nuk janë përfshirë dispozita që përcaktojnë rregullat dhe procedurat për komunikimin dhe shkëmbimin elektronik

të dokumenteve brenda dhe jashtë Qendrës Arsimore, sipas kërkesave të nenit 37 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Lushnje.

Gjithashtu, nuk janë reflektuar disa rregulla të nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit që lidhen me: Menaxhimin e incidenteve; Procedurat dhe indikatorët për matjen e performancës dhe evidentimin e gabimeve; Trajtimin e incidenteve të ndodhura dhe masat përkatëse reaguese; Sigurinë e komunikimeve elektronike; Procedurat për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave (back-up), si dhe veprime të tjera tekniko-organizative që lidhen me teknologjinë e informacionit.

- Qendra e Arsimit në Bashkinë Lushnje nuk ka hartuar plane periodike dhe vjetore për trajnimin dhe kualifikimin e personelit në lidhje me sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe sigurinë e të dhënave. Gjithashtu, mungon bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për Teknologjinë e Informacionit në Bashkinë Lushnje për zhvillimin e trajnimeve për stafin e saj.

- Nga auditimi u konstatua se, shërbimet e teknologjisë së informacionit në Qendrën Arsimore të Bashkisë Lushnje janë të kufizuara dhe operojnë mbi një infrastrukturë të pa konsoliduar. Pajisjet ekzistuese janë të amortizuara dhe ndikojnë negativisht në funksionimin efikas të sistemeve dhe shërbimeve të TI-së. Siguria e rrjetit rezultoi e kompromentuar për shkak të mungesës së elementëve bazë të mbrojtjes, siç janë firewall-i dhe switch-et e menaxhueshëm. Lidhja me internetin realizohet përmes një teknologjie të vjetëruar (ADSL), e cila shkakton ndërprerje të shpeshta dhe ndikon në cilësinë e aksesit në sistemet digjitale.

Aktualisht, Qendra disponon vetëm 6 kompjuterë, të cilët kanë parametra minimale dhe funksionojnë kryesisht me sistemin operativ Windows 7, i cili nuk mbështetet më dhe është i pambrojtur nga kërcënimet kibernetike, duke mos pasur as antivirus funksional. Gjithashtu, përdorimi i software-ve jo të licencuar dhe i pajisjeve të papërshtatshme për përmirësim përbën një rrezik të shtuar për funksionimin dhe sigurinë e të dhënave. Printerat dhe pajisjet periferike janë të vjetra dhe të amortizuara, duke e vështirësuar më tej ofrimin e shërbimeve administrative dhe arsimore në mënyrë efikase.

- Konstatohet se, Qendra Arsimore ka në përdorim 2 DVR dhe 25 kamera sigurie për monitorimin e dy çerdheve dhe një kopshti. Pamjet filmike ruhen për vetëm 12 ditë, për shkak se pajisjet NVR nuk disponojnë kapacitet të mjaftueshëm memorieje për ruajtjen 30-ditore, siç kërkohet nga neni 4 i rregullores për "Monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave në kopshte/çerdhe". Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se specifikimet teknike për këto pajisje, të hartuara nga specialistët e IT-së në Bashki, nuk janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e rregullores, pasi nuk është parashikuar detyrimi, që NVR të kenë memorie për ruajtje 30-ditore.

Gjithashtu, u konstatua se NVR-të e kamerave janë të lidhura me internet, në kundërshtim me nenin 7, pika 2 të rregullores përkatëse. Përveç kësaj, mungojnë dokumentacionet përkatëse që vërtetojnë kryerjen e testeve periodike të funksionimit të kamerave, si dhe procesverbalet e mbajtura nga personat e autorizuar me akses për kontrollin dhe monitorimin e sistemit të vëzhgimit.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim përmirësimit e punës dhe eliminimit të problematikave të konstatuara, janë lënë disa rekomandime si vijon:

- Qendra e Arsimit Lushnje të marrë masa për hartimin dhe implementimin e një plani për teknologjinë e informacionit ku të përfshihen, të gjitha proceset dhe rregullat për zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë e informacionit dhe sigurinë e këtij informacioni;

- Qendra Arsimore, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për sistemet e Teknologjisë së Informacionit të Bashkisë Lushnje, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të rregullores për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave

nga sistemet e kamerave të instaluar në çerdhe dhe kopshte, duke garantuar gjithashtu mbrojtjen e të dhënave filmike.

- Qendra e Arsimit Lushnje të bëjë përmirësimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj, duke përfshirë në këtë rregullore edhe rregullat dhe procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit elektronik brenda qendrës arsimore dhe ti kërkojë Kryetarit të Bashkisë Lushnje miratimin e këtyre ndryshimeve.

- Qendra e Arsimit, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, të marrë masa konkrete për rritjen e transparencës dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke përmirësuar dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit me informacion të plotë dhe të saktë mbi çerdhet, kopshtet, shkollat, aktivitetin e Qendrës Arsimore, si dhe të sigurojë publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve në përputhje me kërkesat ligjore.;

- Qendra Arsimore në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje të marrin masa për përmirësimin e infrastrukturës kompjuterike dhe standardizimin e saj sipas rregullave të nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310, si dhe nenet 3 dhe 14, të ligjit 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" dalim në këtë konkluzion:

Nga auditimi në terren ka rezultuar se, Qendra Arsimore pranë Bashkisë Lushnje nuk ka zhvilluar apo parashikuar sisteme dhe fonde për Teknologjinë e informacionit në buxhetet e viteve 2023-2024, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37 të Rregullores së Brendshme nr.36 ,datë 06.04.2021 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Lushnje".

- Gjithashtu, infrastruktura ekzistuese rezultoi e amortizuar dhe joefikase, ku mungon sigurimi bazë si, firewall dhe switch të menaxhueshëm; pajisjet kompjuterike janë të vjetra dhe përdorin sisteme operative të pasigurta, si dhe mungesë zbatimi të procedurave për sistemet e monitorimit (kamera) në çerdhe dhe kopshte.

Për këto arsye, është e domosdoshme dhe urgjente që të kryhet një studim i detajuar i nevojave për infrastrukturën IT dhe të sigurohen fonde për ndërtimin dhe modernizimin e sistemeve, duke respektuar udhëzimet e AKSHI-t dhe duke u bazuar në praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të programit nr. 1462/1 prot., datë 06.01.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025, në subjektin "Qendrën e Arsimit Lushnje", u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. A, përgjegjës grupi;
2. B. A, auditues;

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrolle të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregulluese, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Drejtimit e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1462/1Prot, datë 06.01.2025:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

1.1 Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

2. Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit

2.1 Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lushnje nr.7, datë 10.02.2016 është krijuar Qendra e Arsimit Lushnje me statusin e njësisë shpenzuese që financohet nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje. Ky institucion është ngritur nga Bashkia Lushnje dhe funksionon si institucion varësie, pasi në kuadër të reformës territoriale vendore të vitit 2016 funksionet e Arsimit Parashkollor, shërbimet mbështetëse dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve kanë kaluar si funksione që administrohen nga pushtetit vendor.

Objekti i punës së kësaj qendre është Administrimi i infrastrukturës së Arsimit Parashkollor nëpërmjet stafëve të shërbimeve mbështetëse (sanitare, roje, etj.); të shkollave të qytetit; të njësisë administrative; të çerdhe, kopshteve; të konviktit të shkollës Mekanike-Bujqësore, si dhe menaxhimi i brigadës së mirëmbajtjes së shkollave, kopshteve dhe çerdheve.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Qendrën e Arsimit Lushnje mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 1462/1 Prot., datë 06.01.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-së. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregulluese mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të dhënave shtetërore”;
- Vendim i Këshillit Bashkiak Lushnje nr.7, datë 10.02.2016 “Krijimi i Qendrës së Arsimit Lushnje”
- Rregulloret përkatëse të Qendrës së Arsimit Lushnje, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumenteve ligjorë, për sistemet informatike që institucioni disponon;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Qendra e Arsimit Lushnje, me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lushnje nr.7, datë 10.02.2016 është krijuar Qendra e Arsimit Lushnje me statusin e njësisë shpenzuese që financohet nga të ardhurat e Bashkisë Lushnje. Ky institucion është ngritur nga Bashkia Lushnje dhe funksionon si institucion varësie, pasi në kuadër të reformës territoriale vendore të vitit 2015 funksionet e Arsimit Parashkollor, Shërbimet Mbështetëse, dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve kanë kaluar si funksione që administrohen nga pushtetit vendor.

Fusha e veprimtarisë së Qendrës së Arsimit Lushnje konsiston në:

- a) Veprimtaria e Qendrës së Arsimit Lushnje zhvillohet mbi bazën e programeve, projekteve dhe planeve mujore;
- b) Kujdeset për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme në institucionet që varen prej saj si shkollat, kopshtet, çerdhet dhe konvikttet;
- c) Në bashkëpunim me zyrën e financës ndjek ecurinë e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave për të gjitha institucionet vartëse dhe ndërhyr në kohë për përmirësimin e gjendjes, në përputhje me fondet e miratuara;
- d) Jep mendime për hartimin e projekt-buxhetit të sektorëve që mbulon, duke i paraprirë me zgjidhje situatave e problemeve që mund të lindin;
- e) Kryen studime për mundësit e shtimit të investimeve që nevojiten në këta sektor, për objekte apo veprimtari të ndryshme dhe i paraqet ato për shqyrtim në Këshill gjatë hartimit të projekt-buxhetit të vitit përkatës;
- f) Në muajin janar të çdo viti bën analizën ekonomike-financiare të veprimtarisë së Qendrës të vitit paraardhës;
- g) Kërkon prej objekteve vartëse kërkesat për furnizimet vjetore dhe mbi bazën e tyre harton plan/furnizimet e vitit;
- h) Monitoron Kopshtet, Çerdhet, Shërbimet;
- i) Organizon punën për mirëmbajtjen e konviktit, kopshteve, çerdheve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK
Në zbatim të pikës 1.a “*Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Burimet njerëzore;
- Aktet rregulluese, identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve në teknologjinë e informacionit;
- Zhvillimi i trajnimeve dhe menaxhimi i kapaciteteve njerëzore në institucion;
- Rregulloret për strukturën IT, përdorimin dhe sigurinë në teknologjinë e informacionit;
- Strategji të IT apo një përfshirje të teknologjisë në strategjinë institucionale;

➤ *Burimet njerëzore*

Qendra e Arsimit Lushnje është krijuar me vendim Nr.07 datë 10.02.2016 të Këshillit Bashkiak. Me Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë nr.308, datë 09.12 2022 dhe nr.335, datë 07.12.2023 janë miratuar respektivisht për vitet 2023 dhe 2024, struktura dhe organika e Qendrës Arsimore të Bashkisë Lushnje.


Struktura e Qendrës së Arsimit Lushnje është e përbërë sipas detyrave dhe funksioneve dhe

përbëhet nga:

- a) Drejtori i Qendrës
- b) Sektori i Arsimit Parashkollor
- c) Qendra Kulturore e Fëmijëve
- d) Shërbimi i Çerdheve
- e) Konviktet dhe Shkollat Mekanike
- f) Sektori Mbështetës Arsimor
- g) Brigada e Mirëmbajtjes së Kopshteve dhe Shkollave
- h) Qendra e personave me aftësi të kufizuara (PAK)
- i) Brigada e Mirëmbajtjes së Institucioneve

Qendra e Arsimit

Bashkia Lushnje



Misioni dhe vizioni i Qendrës së Arsimit Lushnje:

- Veprimtaria e Qendrës së Arsimit zhvillohet mbi bazën e programeve, projekteve dhe planeve mujore.
- Kujdeset për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme në institucionet që varen prej saj si shkollat, kopshtet, çerdhet dhe konviktet.
- Në bashkëpunim me zyrën e financës ndjek ecurinë e realizimit të shpenzimeve dhe të ardhurave për të gjitha institucionet vartëse dhe ndërhyr në kohë për përmirësimin e gjendjes, në përputhje me fondet e miratuara.
- Jep mendime për hartimin e projekt-buxhetit të sektorëve që mbulon, duke i paraprirë me zgjidhje situatave e problemeve që mund të lindin.
- Kryen studime për mundësit e shtimit të investimeve që nevojiten në këta sektor, për objekte apo veprimtari të ndryshme dhe i paraqet ato për shqyrtim në Këshillin Bashkiak gjatë hartimit të projekt-buxhetit të vitit përkatës.
- Në muajin Janar të çdo viti bën analizën ekonomike-financiare të veprimtarisë së Qendrës së Arsimit Lushnje të vitit paraardhës.
- Kërkon prej objekteve vartëse kërkesat për furnizimet vjetore dhe mbi bazën e tyre harton plan/furnizimet e vitit.

Nga auditimi u konstatua se:

Bashkia Lushnje për vitet 2023 dhe 2024 në strukturat organizative nuk ka parashikuar dhe ngritur sektor të teknologjisë së informacionit që të jetë i përfshirë në organikën e Qendrës së Arsimit për të zhvilluar burimet njerëzore me njohuri të mjaftueshme dhe për të kryer shërbimet mbi teknologjinë e informacionit. Shërbimet kryhen nga specialistët IT të bashkisë të cilët nuk i plotësojnë të gjitha nevojat për stafin e Qendrës së Arsimit Lushnje.

➤ **Trajnimet**

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2023-2024 objekt auditimi Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka pasur plan trajnimi vjetor si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore të Qendrës së Arsimit Lushnje.

➤ **Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK**

Standardet e Praktikave më të mira rekomandojnë që Qeverisja TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e aseteve të informacionit dhe mund t'i referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikave duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT. Teknologjia e Informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregulluese.

Nga auditimi u konstatua se, Qendra e Arsimit Lushnje nuk disponon një strategji institucionale, si dhe nuk ka një plan strategjik mbi teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë e informacionit si dhe infrastrukturën TI në të cilën do duhej të ishin pasqyruar objektivat e lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre

-Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, ka rezultuar se Qendra e Arsimit Lushnje nuk disponon regjistër rreziqesh lidhur me teknologjinë e informacionit. Në asnjë formë nuk rezulton

të jenë dokumentuar rreziqe të identifikuara për periudhën objekt auditimi, por as përpara kësaj. Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2 “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të rreziqeve, vlerësimin, kontrollin e rreziqeve që vënë në vështirësi arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”, nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Qendra e Arsimit Lushnje duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe rreziqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi u konstatua se, Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka hartuar regjistër risku lidhur me teknologjinë e informacionit dhe se nuk janë dokumentuar rreziqet e identifikuara për periudhën objekt auditimi, si rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e teknologjinë së informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje.

2.2 Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit

2.1. Siguria e të dhënave, verifikimi i sigurisë fizike dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit

Në zbatim të pikës 2 “*Sistemet informatike , verifikimi i sigurisë fizike dhe siguria e të dhënave*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Verifikime i infrastrukturës dhe networkut të institucionit;
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Informacion mbi Qendrën e Arsimit në web-n e Bashkisë Lushnje;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administronin shërbime të caktuara;
- Vizita në terren;
- Rregullore mbi procedurat e sistemit e TIK dhe buxhetimi e financimi;
- Indikatorë dhe statistika, etj.

➤ **Verifikimi i infrastrukturës dhe networkut në institucion**

Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.36, datë 06.04.2021, është miratuar rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Lushnje. Sipas nenit 1, objekti kësaj rregulloreje është, përcaktimi i rregullave të qëndrueshme për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme të Bashkisë Lushnje, dhe sipas nenit 3, kjo rregullore shtrin efektet e zbatimit të saj mbi personelin e të gjithë niveleve të bashkisë, përfshi administratën qendër, njësitë administrative dhe njësitë e tjera të vartësisë ku në këtë të fundit bën pjesë edhe Qendra e Arsimit.

Në nenin 37 të rregullores janë përcaktuar edhe rregullat e komunikimit elektronik. Sipas këtij neni komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare brenda dhe jashtë bashkisë bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike të bashkisë dhe duke mbajtur parasysh ***rregulloret e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.***

Komunikimi i brendshëm në bashki realizohet nëpërmjet rrjetit elektronik dhe intranetit dhe ky rrjet kompjuterik i brendshëm është pronë e Bashkisë Lushnje. Me anë të rrjeti kompjuterik shkëmbehen dhe merren informacione që kanë lidhje me fushat përkatëse që mbulojnë drejtoritë duke lehtësuar aktivitetin e tyre.

Auditimit mbi verifikimin e infrastrukturës dhe networkut në institucion, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe ligjit Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” Neni 8 Parimi i ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike, pikat:

d) rregullimin dhe harmonizimin e planeve dhe projekteve të digjitalizimit në përputhje me standardet dhe udhëzimet e ndërtimit të infrastrukturës së qeverisjes elektronike sipas praktikave të Bashkimit Evropian;

ë) garantimin e qëndrueshmërisë së investimeve me ndryshimet teknologjike dhe zhvillimin e kërkesave që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Nga auditimi u konstatua se:

- Evidentohet se, në zbatim të kësaj rregulloreje, bashkia nuk ka ngritur në Qendrën e Arsimit një rrjet të mirëfilltë elektronik interneti dhe intranetit për marrjen dhe shkëmbimin e informacione si brenda strukturave të vetë Qendrës Arsimore ashtu edhe me bashkinë apo institucionet e tjera vartëse të saj.

- Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka sisteme për të zhvilluar teknologjinë e informacionit;

- Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe një pjesë është e amortizuar duke ndikuar negativisht dhe në shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet;

- Siguria e infrastrukturës network në Qendrën e Arsimit Lushnje është e kompromentuar si rezultat i mungesës së: Firewall Hardware e Switch të menaxhueshëm.

- Infrastruktura Network në Qendrën e Arsimit Lushnje është e përberë nga një modem ADSL i lidhjes së internetit me një switch me porta automatike është një teknologji e përdorur për të ofruar akses në internet ku shpejtësia e ngarkimit është më e ulët se ajo e shkarkimit por teknologjia e internetit ka përparuar dhe ofruesit e shërbimeve po përqendrohen më shumë te VDSL dhe fibrat optike, që ofrojnë shpejtësi dhe kapacitet më të lartë.
- Nuk ka një linjë back up interneti në rast të shkëputjes së linjës, duke sjellë kështu mos funksionim të sistemit dhe ndërprerje të ofrimit të shërbimeve.

Qendra e Arsimit Lushnje ka në inventar të 6 kompjuterë dhe nga *auditimi u konstatua se:*

- Këto Pajisje PC kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht (rreth 85%) kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprerë suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë PC-të e punonjësve dhe rrjetin network të Qendrës së Arsimit Lushnje vulnerabël ndaj sulmeve dashakeq;
- Pajisjet PC nuk kanë të instaluar software Antivirus;
- Sistemet e operimit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;
- Në këta kompjutera nuk mund të bëhet upgrade në Windows 10/11;
- Po kështu ka në inventarin e Qendrës së Arsimit 3 printera ose Pajisje periferike të cilët janë kryesisht modele të vjetra, por edhe të amortizuara.
- Nuk ka një server qëndror të pajisur me Active Directory Domain Controller për menaxhimin e përdoruesve dhe vendosjen e politikave të sigurisë.
- Nuk kanë një pajisje firewall për mbrojtjen e rrjetit nga sulmet e jashtme.

Qendra e Arsimit ka në inventar 2-DVR dhe 25 telekamera te cilat shërbejnë për të monitoruar çerdhe nr.1 dhe çerdhe nr.2 dhe kopshtin nr.3. Me Vendim Nr.269 datë 24.07.2024 kryetari bashkisë ka miratuar rregullore “Monitorimin , regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave të instaluar në kopshte/çerdhe Qendra e Arsimit Lushnje”. Në këtë rregullore janë përcaktuar procedurat standardet dhe përgjegjësit përkatëse lidhur me monitorimin, regjistrimin, transmetimin dhe administrimin e pamjeve që regjistrohen.




Foto 1 dhe 2: Pamje të DVR në çerdhe

Nga auditimi u konstatua se:

- Regjistrimi i pamjeve filmike të kamerave ruhet 11 ditë pasi (NVR)-t nuk kanë memorie për të ruajtur në afatin e përcaktuar të rregullores prej 30 ditë kalendarike në kundërshtim me nenin 4 të rregullores së sipërcituar;

- Gjithashtu në specifikimet teknike të hartuara nga specialistet IT në bashki për blerjen e kamerave nuk janë hartuar në përputhje me rregulloren;
- NVR janë të lidhura me internet në kundërshtim me Nenin 7 pika 2 të rregullores;
- Nuk janë mbajtur procesverbale testimi në mënyrë periodike ;
- Nuk janë mbajtur procesverbale për personat nga personat që janë autorizuar për akses;

➤ **Auditimi i Sistemeve dhe i Sigurisë së Informacionit**

Siguria e Informacionit është një proces i vlerësimit të sigurisë së informacionit në Institucion për të identifikuar dhe adresuar rreziqet dhe incidentet e mundshme. Ky proces ndihmon Institucionet të sigurojnë që të dhënat dhe informacioni të jenë të mbrojtur dhe të sigurt, të përmbushin kërkesat e ligjeve dhe standardeve të sigurisë së informacionit, dhe të rrisin ndërgjegjësimin e punonjësve të Institucioneve rreth sigurisë së informacionit dhe rreziqeve të mundshme.

Auditimi i sigurisë së informacionit identifikon sfidat dhe rreziqet e mundshme në nivelin e sigurisë së informacionit dhe ndihmon në zhvillimin e strategjive për t'i përballuar ato. Në të njëjtën kohë, ai identifikon politikat dhe procedurat e sigurisë së informacionit dhe vlerëson se a janë ato të përshtatshme dhe të ndjekura me përpikëri nga punonjësit e Institucionit. Çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë:

“Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion;
- Rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre;
- Nuk ka, rregullore për sigurinë dhe komunikimet elektronike, dokumentacion mbi procedurat e ruajtjes së të dhënave back up, dokumentacion mbi procedurat e veprimeve të ndryshme.

➤ **Informacion për Web-in e Qendrës së Arsimit**

Në kuadrin e programit të transparencës bazuar në Ligjin 119/2014 datë 18.09.2014. “Për të drejtën e informimit”, Bashkia Lushnje ka të afishuar në faqen e saj web (<https://bashkialushnje.gov.al/>), informacion mbi Qendrën e Arsimit Lushnje.

Nga navigimit mbi rubrikën e publikuar u konstatua se, nuk është përditësuar informacioni pasi:

- Nuk regjistrohen kërkesat dhe përgjigjet;
- Nuk ka informacion për çerdhet;
- Nuk ka informacion për kopshtet;
- Nuk ka informacion për shkollat;
- Nuk ka informacion të detajuar për Qendrën e Arsimit;

➤ **Rregullore Brendshme**

- Qendra e Arsimit për vitin 2023 , por dhe para këtij viti nuk ka pasur rregullore të brendshme për organizimin dhe funksionim e kësaj Qendre. Ndërsa në vitin 2024 me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lushnje nr. 288, datë 15.08.2024, është miratuar rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Arsimore Bashkia Lushnje.

Nga auditimi u konstatua se:

- Në këtë rregullore ndryshe nga rregullorja e Bashkisë Lushnje e sipërcituar nuk janë përcaktuar rregulla dhe procedura të dokumenteve zyrtarë edhe termat e veçanta për teknologjinë e informacionit për komunikimin dhe shkëmbimin elektronik brenda dhe jashtë qendrës për të implementuar në vijimësi zbatimin e rregullores së bashkisë nën frymën e nenit 37 të miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.36, datë 06.04.2021.

-Buxheti dhe Financimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (TIK).

Me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lushnje nr.119,datë 21.12.2022 është miratuar buxheti i Bashkisë Lushnje për vitin 2023. Dhe me shkresën e Kryetarit të Bashkisë nr.11354, datë 27.12.2022 është dërguar pjesa e buxhetit të detajuar të këtij viti që i përket Qendrës Arsimore. Evidentohet se Qendra Arsimore për vitin 2023 nuk ka paraqitur projekt-buxhet pranë bashkisë për nevojat e ushtrimit të aktivitetit të saj në të cilin duhet të përfshiheshin edhe kërkesat për buxhet për ngritja dhe funksionimin e sistemit mirëfilltë të teknologjisë së informacionit në këtë institucion.

Kërkesat për buxhet për Qendrën Arsimore janë hartuar dhe parashikuar nga vetë Bashkia Lushnje. Kështu në buxhetin e vitit 2023 bashkia ka parashikuar buxhet për Qendrën Arsimore në zërin investime në pajisje (231) në vlerën totale 4,301,464 lekë e cila paraqitet me realizim në vlerën 3,402,413 lekë. Në këtë vlerë investimi për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të teknologjisë së informacionit është përfshirë vetëm blerja dhe vendosje e 17 kamerave për çerdhet nr.1 dhe nr.2 të Qytetit, në vlerën e prokuruar 249,300 lekë dhe të realizuar në vlerën 229,620 lekë, dhe blerja e 3 kompjuterëve në vlerë e prokuruar 135,000 lekë dhe të realizuar në vlerën 90,000 lekë.

Me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lushnje nr. 103, datë 21.12.2023 është miratuar buxheti i bashkisë Lushnje për vitin 2024. Dhe me shkresën e Kryetarit të Bashkisë nr.7044, datë 28.12.2023 është dërguar pjesa e buxhetit të këtij viti që i takonte Qendrës Arsimore Lushnje. Qendra e Arsimit Lushnje për vitin 2024 ka paraqitur kërkesat për buxhet (projekt-buxhetin) pranë bashkisë me shkresë nr.494, datë 13.10.2023. Në këtë projekt-buxhet ka kërkuar fonde për investime për blerjen pajisje të cilat janë akorduar në vlerën 800,000 lekë dhe të realizuara në vlerën 624,000 lekë. Në këtë vlerë për ngritjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit është përfshirë vetëm blerja e 8 kamerave për kopshtin nr. 3, në vlerën prokuruar dhe të e realizuar në shumën 123,900 lekë .

Nga auditimi u konstatua se: Bashkia Lushnje dhe Qendra Arsimore Lushnje nuk kanë parashikuar në projekt buxhetet e vitit 2023 dhe 2024, fonde për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit sipas kërkesave të nenit 37 të rregullores së Brendshme të Bashkisë Lushnje duke mbajtur në konsideratë edhe rregulloret e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar nuk është paraqitur obsevacion.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Qendra e Arsimit Lushnje nuk ka hartuar dhe miratuar një plan strategjik për të ngritur dhe zhvilluar sistem të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë Lushnje, shtrin efektet e zbatimit të saj mbi të gjithë nivelet e bashkisë, përfshi edhe Qendrën e Arsimit Lushnje. Në këtë rregullore janë përcaktuar hollësisht edhe rregullat për shkëmbimin elektronik të dokumenteve zyrtare brenda dhe jashtë bashkisë. Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike të bashkisë dhe duke mbajtur parasysh rregulloret e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Referuar rregullores u konstatua se, në zbatim të kësaj rregulloreje, bashkia nuk ka ngritur në Qendrën e Arsimit një rrjet të mirëfilltë elektronik interneti dhe intranetit për marrjen dhe shkëmbimin e informacione si brenda strukturave të vetë qendrës arsimore ashtu edhe më bashkinë apo institucionet e tjera vartëse të saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje të marrë masa për hartimin dhe implementimin e një plani për teknologjinë e informacionit ku të përfshihen, të gjitha proceset dhe rregullat për zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe sigurinë e këtij informacioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandim: Qendra Arsimit Bashkia Lushnje të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Bashkinë Lushnje për të ngritur në Qendrën e Arsimit një rrjet elektronik interneti dhe intraneti, për marrjen dhe shkëmbimin e informacione si brenda strukturave të vetë qendrës arsimore ashtu edhe me bashkinë apo institucionet e tjera vartësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrat e Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura dhe organika e Qendrës Arsimore të Bashkisë Lushnje për vitet 2023 dhe vitin 2024, ku në asnjërin vit nuk është parashikuar ngritja e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe as përfshirja e një pozicioni specialisti për këtë fushë. Kjo situatë pengon implementimin e rregullave të komunikimit dhe shkëmbimit elektronik të dokumenteve zyrtare. Mungesa e këtij sektori dhe e stafit të specializuar ka penguar dhe vijon të pengojë implementimin e duhur të rregullave për komunikimin dhe shkëmbimin elektronik të dokumenteve zyrtare, duke mos respektuar rregulloret e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe kërkesat e nenit 37 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë Lushnje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, të analizojë dhe të konsiderojë mundësinë e përfshirjes në strukturën organike të saj specialist të teknologjisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje për vitin 2023, nuk ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionim e saj. Ndërsa, në vitin 2024 është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Lushnje, rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Arsimore. Specifikisht, në rregulloren e vitit 2024 nuk janë përfshirë dispozita që përcaktojnë rregullat dhe procedurat për komunikimin dhe shkëmbimin elektronik të dokumenteve brenda dhe jashtë Qendrës Arsimore, sipas kërkesave të nenit 37 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Bashkisë Lushnje.

Gjithashtu, nuk janë reflektuar disa rregulla të nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit që lidhen me: Menaxhimin e incidenteve; Procedurat dhe indikatorët për matjen e performancës dhe evidentimin e gabimeve; Trajtimin e incidenteve të ndodhura dhe masat përkatëse reaguese; Sigurinë e komunikimeve elektronike; Procedurat për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave (back-up), si dhe veprime të tjera tekniko-organizative që lidhen me teknologjinë e informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit Lushnje të bëjë përmirësimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj, duke përfshirë në këtë rregullore edhe rregullat dhe procedurat e komunikimit dhe shkëmbimit elektronik brenda qendrës arsimore dhe ti kërkojë Kryetarit të Bashkisë Lushnje miratimin e këtyre ndryshimeve.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Qendra e Arsimit në Bashkinë Lushnje nuk ka hartuar plane periodike dhe vjetore për trajnimin dhe kualifikimin e personelit në lidhje me sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe sigurinë e të dhënave. Gjithashtu, mungon bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për Teknologjinë e Informacionit në Bashkinë Lushnje për zhvillimin e trajnimeve për stafin e saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje të marrë masa që të hartojnë plane periodike dhe vjetore për zhvillimin e trajnimeve të punonjësve, për sistemet e teknologjisë së informacionit si dhe trajnimet për sigurinë kibernetike, që ofron në mënyrë periodike Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Qendra e Arsimit Lushnje për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar regjistër rrishtur me teknologjinë e informacionit dhe se nuk janë dokumentuar në mospërputhje me: nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të rrishtur në njësitë publike.” Rreziqet e identifikuar, si rreziqet e biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e teknologjinë së informacionit në Qendrën e Arsimit Lushnje.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-10, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje të hartojë regjistrin e rrishtur, për të analizuar dhe identifikuar rreziqet për Teknologjinë e Informacionit dhe sigurinë e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, shërbimet e teknologjisë së informacionit në Qendrën Arsimore të Bashkisë Lushnje janë të kufizuara dhe operojnë mbi një infrastrukturë të pa konsoliduar. Pajisjet ekzistuese janë të amortizuara dhe ndikojnë negativisht në funksionimin efikas të sistemeve dhe shërbimeve të TI-së. Siguria e rrjetit rezultoi e kompromentuar për shkak të mungesës së elementëve bazë të mbrojtjes, siç janë firewall-i dhe switch-et e menaxhueshëm. Lidhja me internetin realizohet përmes një teknologjie të vjetëruar

(ADSL), e cila shkakton ndërprerje të shpeshta dhe ndikon në cilësinë e aksesit në sistemet digjitale.

Aktualisht, Qendra disponon vetëm 6 kompjuterë, të cilët kanë parametra minimale dhe funksionojnë kryesisht me sistemin operativ Windows 7, i cili nuk mbështetet më dhe është i pambrojtur nga kërcënimet kibernetike, duke mos pasur as antivirus funksional. Gjithashtu, përdorimi i software-ve jo të licencuar dhe i pajisjeve të papërshtatshme për përmirësim përbën një rrezik të shtuar për funksionimin dhe sigurinë e të dhënave. Printerat dhe pajisjet periferike janë të vjetra dhe të amortizuara, duke e vështirësuar më tej ofrimin e shërbimeve administrative dhe arsimore në mënyrë efikase.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 10-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandim: Qendra Arsimore në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje të marrin masa për përmirësimin e infrastrukturës kompjuterike dhe standardizimin e saj, sipas rregullave të nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Qendra Arsimore ka në përdorim 2 DVR dhe 25 kamera sigurie për monitorimin e dy çerdheve dhe një kopshti. Pamjet filmike ruhen për vetëm 12 ditë, për shkak se pajisjet NVR nuk disponojnë kapacitet të mjaftueshëm memorieje për ruajtjen 30-ditore, siç kërkohet nga neni 4 i rregullores për “Monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të sistemit të kamerave në kopshte/çerdhe”. Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se specifikimet teknike për këto pajisje, të hartuara nga specialistët e IT-së në Bashki, nuk janë ndërtuar në përputhje me kërkesat e rregullores, pasi nuk është parashikuar detyrimi, që NVR të kenë memorie për ruajtje 30-ditore.

U konstatua se NVR-të e kamerave janë të lidhura me internet, në kundërshtim me nenin 7, pika 2 të rregullores përkatëse. Përveç kësaj, mungojnë dokumentacionet përkatëse që vërtetojnë kryerjen e testeve periodike të funksionimit të kamerave, si dhe procesverbalet e mbajtura nga personat e autorizuar me akses për kontrollin dhe monitorimin e sistemit të vëzhgimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 10-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandim: Qendra Arsimore, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për sistemet e Teknologjisë së Informacionit të Bashkisë Lushnje, duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të rregullores për monitorimin, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave nga sistemet e kamerave të instaluar në çerdhe dhe kopshte, duke garantuar gjithashtu mbrojtjen e të dhënave filmike.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në kuadër Programit të Transparencës, bazuar në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, Bashkia Lushnje ka publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit informacion mbi Qendrën e Arsimit Lushnje. Megjithatë, nga një analizë e përmbajtjes së rubrikave të publikuara, konstatohet se informacioni nuk është përditësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë. Specifikisht, mungon informacioni i detajuar për çerdhet, kopshtet dhe institucionet arsimore në varësi të kësaj qendre.

Po ashtu, nuk është i publikuar informacioni i plotë mbi vetë Qendrën e Arsimit, strukturën, funksionet, personelin apo aktivitetet e saj. Një tjetër mangësi e evidentuar është mungesa e regjistrit të kërkesave për informacion dhe përgjigjeve të dhëna, i cili është një element thelbësor për garantimin e transparencës dhe llogaridhënies publike, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 10-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandim: Qendra e Arsimit, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, të marrë masa konkrete për rritjen e transparencës duke përmirësuar dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të internetit me informacion të plotë dhe të saktë mbi çerdhet, kopshtet, shkollat, aktivitetin e Qendrës Arsimore, si dhe të sigurojë publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Me Vendimet e Këshillit të Bashkisë janë miratuar buxhetet e Bashkisë Lushnje për vitet 2023 dhe 2024, ku përfshihen edhe fondet e destinuar për Qendrën Arsimore. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2023, Qendra Arsimore nuk ka paraqitur një projekt-buxhet pranë Bashkisë për mbulimin e nevojave të saj operacionale. Në mungesë të këtij dokumenti, kërkesat buxhetore për këtë institucion janë hartuar dhe përfshirë në buxhetin e bashkisë nga vetë administrata e saj.

Ndërkohë, për vitin 2024, Qendra Arsimore ka ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe ka paraqitur kërkesat e veta buxhetore pranë Bashkisë Lushnje. Megjithatë, analizat tregojnë se në të dy vitet nuk janë parashikuar fonde të dedikuara për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në këtë institucion.

Më konkretisht, në vitin 2023, i vetmi shpenzim në këtë drejtim ka qenë parashikimi i një fondi prej 249,300 lekë për blerjen dhe vendosjen e 17 kamerave sigurie në çerdhet nr. 1 dhe nr. 2 të qytetit, si dhe 135,000 lekë për blerjen e 3 kompjuterëve.

Për vitin 2024, Qendra Arsimore ka kërkuar dhe përfshirë në buxhetin e saj një fond prej 123,900 lekë për blerjen dhe vendosjen e 8 kamerave në kopshtin nr. 3. Këto investime janë të fokusuar kryesisht në sistemet e monitorimit dhe nuk përfshijnë elementë të tjerë të domosdoshëm për ngritjen e një infrastrukture funksionale të teknologjisë së informacionit, si shkak i mungesës në planifikimin dhe prioritarizimin e fushës së teknologjisë së informacionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandim: Qendra Arsimore në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, bazuar në rregullat e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacioni dhe në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, të marrë masa për ngritjen e një grup pune të përbashkët për të studiuar dhe analizuar nevojën për zhvillimin dhe financimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Qendrën Arsimore.

Brenda muajit qershor 2025

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT